

Further Analysis of the Characteristics for Financial Distress: A Qualitative Approach

Zhaklina Dhamo, PhD Candidate,
University of Tirana, Economic Faculty, Albania
E-mail: zh.dhamo@gmail.com

Vasilika Kume, Professor,
University of Tirana, Economic Faculty, Albania
E-mail: vasilika.kume@unitir.edu.al

Analiza e mëtejshme e karakteristikave për vështirësinë financiare: Një qasje cilësore

Zhaklina Dhamo, Kandidate për Dokt. Shkencash,
Fakultetit i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Adresa e emailit: zh.dhamo@gmail.com

Vasilika Kume, Profesore,
Fakultetit i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Adresa e emailit: vasilika.kume@unitir.edu.al

Abstract: *This research studies the potential reasons for financial distress of companies in the telecommunication, energy, and construction sector in Albania. We use a revised version of the survey suggested by Nikolic et al. (2015) for identifying differences in management characteristics of the three industries considered in this research. We observe differences in prioritizing work time, cash management competences, and ranking the internal and external factors that influence companies' operational problems.*

Key words: *Qualitative Survey, Financial Distress, Industry Characteristics*

Abstrakt: *Ky punim studion arsyet potenciale për vështirësitë financiare të kompanive në sektorin e telekomunikacionit, energjisë dhe ndërtimit në Shqipëri. Ne përdorëm një version të rishikuar të anketës së sugjeruar nga Nikolic et al. (2015) për identifikimin e ndryshimeve në karakteristikat e menaxhimit të tre industrive të konsideruara në këtë studim. Ne vëzhguam dallimet në prioritarizimin e kohës së punës, aftësitë e menaxhimit të parave, renditja e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë tek problemet operacionale të kompanive.*

Fjalët kyce: *vëzhgim cilësor, vështirësi financiare, karakteristikat e industrisë*

JEL Classification: *L2, L26, L74, L96*

I. Introduction

This research is a continuation of the work of Dhamo and Kume (2015), regarding the quantitative assessment of the default potential for the telecommunication, energy, and construction sector in Albania. In this paper, using a modified version of the methodology proposed by Nikolic et al. (2015), our effort is focused on the qualitative analysis of the causes for the financial performance, from a bankruptcy potential perspective, of the three industries mentioned above.

I. Hyrje

Ky studim është vazhdimësi e punës së Dhamo & Kume (2015) në lidhje me vlerësimin sasior të potencialit falimentues të sektorëve të telekomunikacionit, energjisë dhe ndërtimit në Shqipëri. Në këtë punim, duke përdorur një version të modifikuar të metodologjisë së propozuar nga Nikolic et al. (2015), jemi përqëndruar në analizën cilësore të shkaqeve për performancën financiare nga një perspektivë e mundshme falimentimi për tre industritë e lartpërmendura.

In his seminal work, Altman (1968) identified five factors that highly contributed to the financial distress of companies, which represent liquidity, profitability, asset productivity, leverage and sales generation ability. These five factors were used to assess the linear Z score model of Altman, with 94% bankruptcy prediction accuracy. Altman and Heine (2000) proposed two revised versions of the original Z model, Z' and Z". The changes were influenced by the limitation of the original model in assessing the bankruptcy potential of privately held companies, and not considering the industry effect.

The quantitative assessment of the probability of failure is indeed important, but it does not explain much about the reasons of the deterioration of the financial/operational ratios that influence financial distress. Gaskill et al. (1993) find that retail businesses poor managerial functions, among which inadequate knowledge of pricing strategies, ineffective advertising/promotional strategy, failure to generate long term business plan and personnel plan, are a factor of failure. Ropega (2011) confirms that the combination of both financial and organizational analyses, although the latter are more subjective according to the author, may help the company identify corrective actions. Heracleous and Werres (2015) identify six inter-related factors of strategic misalignment, beginning with dysfunctional leadership and corporate governance, and moving on with unduly risky strategic actions, and the following lax execution.

Ahmad and Seet (2009) find that in two different countries, Australia and Malaysia, failure to have clear business direction, conduct research, recognize opportunities, as well as lacking the organization and relationship skills and the ability to make good business judgment are commonly perceived reasons for failure of both countries' business owners. In the attempt to study the difference between successful and failed entrepreneurs, Zilbershtein (2013) evidences that successful entrepreneurs are characterized by proactive behavior, viewing the business as people

Në studimin e tij bazë, Altman (1968) identifikoi pesë faktorët që kanë një ndikim të madh në vështirësitë financiare të firmave. Këta faktorë përfaqësojnë likuiditetin, përfitueshmërinë, produktivitetin e aktiveve, levën financiare dhe aftësinë gjeneruese të shitjeve. Këto pesë faktorë janë përdorur për të vlerësuar modelin linear Z të Altman, me 94 % saktësi në parashikimin e falimentimit. Altman dhe Heine (2000) propozuan dy versione të rishikuara të modelit origjinal Z, Z' dhe Z". Ndryshimet u ndikuan nga kufizimet e modelit origjinal në vlerësimin e potencialit për falimentimin e kompanive private pa marrë parasysh efektin e industrisë.

Vlerësimi sasior i probabilitetit të dështimit është me të vërtetë i rëndësishëm, por ky vlerësim nuk shpjegon shumë arsyet e përkeqësimit të raporteve financiare/operacionale që ndikojnë në vështirësinë financiare. Gaskill et al. (1993) gjetën se tek bizneset e shitjes me pakicë me funksione të dobëta menaxheriale, përveç njohurive të pamjaftueshme mbi strategjinë e çmimeve, reklamave të paefektshme/strategjive promovuese, mosbërja e një plani afatgjatë të biznesit dhe planit të personelit, është një faktor i dështimit tek këto biznese. Ropega (2011) konfirmoi kombinimi i dy analizave financiare dhe organizative, edhe pse këto të fundit janë më shumë subjektive sipas autorit, mund të ndihmojnë kompaninë në identifikimin e veprimeve korrigjuese. Heracleous & Werres (2015) identifikuan gjashtë faktorë të ndërlidhur të një procesi jo strategjik, duke filluar nga udhëheqja jofunksionale, qeverisja e korporatave dhe duke vazhduar me veprimet e pasakta dhe të rrezikshme strategjike, që përfundojnë me ekzekutimin e dobët.

Ahmad & Seet (2009) treguan se në dy vende të ndryshme, Australi dhe Malajzi, paaftësia për të patur një drejtim të qartë të biznesit, mosbërja e kërkimeve, mosnjohja e mundësive, mungesa në organizim dhe në krijimin e marrëdhënieve, paaftësia për të bërë gjykim të mirë të biznesit janë arsye të zakonshme të dështimit të pronarëve të bizneseve të këtyre dy vendeve.

Në përpjekje për të studiuar dallimin ndërmjet sipërmarrësve të suksesshëm dhe të dështuar, Zilbershtein (2013) dëshmon se sipërmarrësit e suksesshëm karakterizohen nga sjellje proaktive, ata e shohin

centered entity, engaging others in their decision process, and viewing their family as part of their success.

Inspired by the suggestions of Mellahi and Wilkinson (2004), who highlight the need of considering both contextual forces and organizational dynamics in studying business failure, our research is part of a bigger research that studies roots and symptoms of business failure for Albanian companies. As suggested by Gaskill et al. (1993), we focus our research on an industry basis. After investigating Altman's Z' and Z" failure model performance, and ratio characteristics of the telecommunication, energy, and construction industry in Albania in the paper of Dhamo and Kume (2015), this research presents a survey conducted in the fifteen companies (five in each industry) considered in the previous research. In line with the survey methodology of Nikolic et al. (2015) for financially distressed SMEs, the CEOs or CFOs of fifteen companies in the telecommunication, energy and construction industry in Albania, have answered questions that focused on the individual characteristics of the manager, and non-individual characteristics of the company. We expand the survey proposed by Nikolic et al. (2015) to understand more in terms of financial decision making of the company.

This research continues with the methodology. Next section is the analysis of the answers of the survey. The last section summarizes the conclusion of this paper.

II. Methodology

We use a modified version of the methodology of Nikolic et al. (2015) for conducting the survey in the 15 businesses, which were quantitatively assessed in terms of failure potential in the work of Dhamo and Kume (2015), as per the Z' and Z" failure predicting models suggested by Altman and Heyne (2000).

Nikolic et al. (2015) aims to test, through their survey framework, whether individual characteristics of entrepreneurs and/or non-individual characteristics of SMEs affect failure of the company under the survey. In their research framework, the

biznesin si një entitet më njerëzit në qendër të tij, angazhojnë të tjerët në procesin e vendimmarrjes dhe i shohin familjet e tyre si pjesë e suksesit.

Frymëzuar nga sugjerimet e Mellahi & Wilkinson (2004), të cilët nxjerrin në pah nevojën e shqyrtimit të dy forcave kontekstuale dhe dinamikën organizative në studimin mbi dështimin e biznesit, kërkimet tona janë pjesë e një kërkimi më të madh që studion rrënjët dhe simptomat e dështimit të biznesit për kompanitë shqiptare. Siç sugjerohet nga Gaskill et al. (1993), ne e fokusojmë kërkimin tonë mbi bazën e industrisë.

Pas studimit të performancës së modelit Z' dhe Z" mbi dështimin nga Altman dhe karakteristikat e raporteve financiare për industrinë e telekomunikacionit, energjisë dhe ndërtimit në Shqipëri, sipas studimit të Dhamo & Kume (2015), ky punim paraqet një studim të kryer nëpër pesëmbëdhjetë kompani (pesë në çdo industri) të konsideruara në kërkimet e mëparshme. Në përputhje me metodologjinë e studimit të Nikolic et al. (2015) për NVM-të në gjendje të vështirë financiare, CEO-t apo CFO-t e pesëmbëdhjetë kompanive të industrisë së telekomunikacionit, energjisë dhe ndërtimit në Shqipëri i janë përgjigjur pyetjeve që fokusohen në karakteristikat individuale të menaxherit dhe karakteristikat jo-individuale të firmës. Ne e zgjeruam sondazhin e propozuar nga Nikolic et al. (2015) për të kuptuar më shumë në termat e vendimmarrjes financiare të firmës.

Ky studim vijon me metodologjinë. Seksioni tjetër është analiza e përgjigjeve të sondazhit. Pjesa e fundit përmbledh konkluzionet e këtij punimi.

II. Metodologjia

Ne po përdorim një version të modifikuar të metodologjisë së Nikolic et al. (2015) për kryerjen e këtij anketimi në 15 biznese, të cilët u vlerësuan në terma sasiorë në aspektin e potencialit të dështimit në punën e Dhamo & Kume (2015), sipas modeleve Z' dhe Z" të sugjeruara nga Altman & Heyne (2000) që parashikojnë dështimin.

Nikolic et al. (2015) ka për qëllim të provojë, përmes anketës, nëse karakteristikat individuale të sipërmarrësve dhe/ose karakteristikat jo-individuale të NVM-ve ndikojnë në dështimin e firmës që anketohet.

authors categorized the individual characteristics in demographics, professional experience, motivation of SME startup, personal characteristics.

Nikolic et al. (2015) categorize SME characteristics as internal such as business age, sector, life cycle in time of distress, number of employees, financial resources, infrastructure in the surrounding region of SME operations, and external such as political, economic and social issues, as well as technological, ecological and legislative issues. The result of the research framework of Nikolic et al. (2015) is a questionnaire to be used for analyzing reasons of SME failure.

We revised the questionnaire suggested by Nikolic et al. (2015), by changing the approach questions number 10, 11, 12, 13, 14, 20 from 'rating' the importance of some individual/SME characteristics, to 'ranking' the importance of this individual/SME characteristics. We added eight questions regarding the financial decision making of the company, such as cash management, the use of dividends from the shareholders, fixed assets of the company, and a factor that affects the investment decision of the respondent.

The revised questionnaire was presented to the fifteen businesses representing the telecommunication, energy and construction sector in the research of Dharmo and Kume (2015). These companies are part of the 'VIP' list of the Albanian Tax Authority. The analysis of the survey result is presented in the next section.

III. Analysis of the result

All managers, who responded to our survey are between 35 and 45 years old, married, hold a master degree and have a technical field vocation. Almost 17% of the respondents are female.

Most of the respondents in the telecommunication sector spend more than 50 hours per week at work, out of which 20-30 hours are spent on strategic problems/decision making, and less than 20-30 hours are spent on administrative work. The respondents from the telecommunication sector like to spend their free time mainly with family, personal hobbies and traveling. The need for achievement, risk

Në kuadër të kërkimit të tyre, autorët kategorizojnë karakteristikat individuale në demografike, përvojën profesionale, motivimin për fillimin e NVM-ve dhe karakteristikat personale. Nikolic et al. (2015) i kategorizojnë karakteristikat e NVM-ve në të brendshme, si moshë e biznesit, sektori, cikli i jetës në kohën e vështirësisë financiare, numri i të punësuarve, burimet financiare, infrastruktura në rajon dhe në të jashtme, si çështjet politike, ekonomike, sociale, teknologjike, ekologjike dhe ato legjislativë. Rezultati i kuadrit kërkimor të Nikolic et al. (2015) është një pyetësor që do të përdoret për të analizuar arsytet e dështimit të NVM-ve.

Ne e rishikuar pyetësorin e sugjeruar nga Nikolic et al. (2015) duke ndryshuar pyetjet për pyetjet numër 10, 11, 12, 13, 14 dhe 20 nga „klasifikimi” i rëndësisë së disa karakteristikave individuale të NVM-ve, në „renditje” të rëndësisë së këtyre karakteristikave. Ne shtuam tetë pyetje në lidhje me marrjen e vendimeve financiare të firmës, të tilla si menaxhimi i parave, përdorimi i dividendëve nga aksionerët, aktivet fikse të kompanisë dhe faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimit për investime nga të anketuarit.

Pyetësori i rishikuar u krye në pesëmbëdhjetë biznese që përfaqësojnë sektorin e telekomunikacionit, energjisë dhe ndërtimit në studimin e Dharmo & Kume (2015). Këto kompani janë pjesë e listës "VIP" të Autoritetit Tatimor Shqiptar. Analiza e rezultatit të anketës paraqitet në seksionin tjetër.

III. Analiza e Rezultateve

Të gjithë menaxherët që iu përgjigjën sondazhit tonë janë të moshës ndërmjet 35 dhe 45 vjeç, të martuar, kanë një diplomë master dhe kanë një profesion të fushës teknike. Pothuajse 17 % e tyre janë femra. Shumica e të anketuarve në sektorin e telekomunikacionit shpenzojnë më shumë se 50 orë në javë në punë, nga të cilat 20-30 orë shkojnë për problemet/vendimarrjen strategjike dhe 20-30 orë shpenzohen për punë administrative. Të anketuarit nga sektori i telekomunikacionit pëlqejnë të kalojnë kohën e tyre të lirë kryesisht me familjen, të ndjekin pasionet e tyre personale dhe pëlqejnë të udhëtojnë. Nevoja për arritje, marrja përsipër e riskut dhe

taking and internal locus of control are the most important factors for company's success, according to the telecommunications sector managers, who responded to this survey. This group considers mainly self-fulfillment, job satisfaction and good network a motivation for entrepreneurial startup. The telecommunication sector ranks economic and legislative issues as the main external influencers for corporate operational problems. Difficulties in absorption/ acquisition of new technology/ innovation and management of receivables are considered the main company's internal problematic issues from this group. Generally, for the telecommunication sector, the finance manager is the decision maker for the cash management. The main factor affecting their decision for telecommunication managers, when considering a new investment, is generally the expected earnings from this investment. The possibility to invest in a more innovative asset mainly affects the sale of an existing asset decision of the respondents in the telecommunication sector. The possibility to increase capacities and the supply of electricity are main external components that affect telecommunication business performance, according to the respondents of this survey. Telecommunication managers, generally, consider their companies almost fully recovered from distress, and for achieving this they needed less than three years.

The construction managers, who responded to our survey, dedicate 20-30 hours per week to corporate strategic decisions issues, and 20-30 hours per week to administrative work. Like the telecommunications managers, they would spend more time with family and their hobbies. Risk taking and internal locus of control are the most important factors for companies' success, according to this group. Independence and financial motivation, according to construction managers, who responded to our survey, are the key motivation for entrepreneurial startup. Like telecommunication managers, construction respondents rate as main external sources of company's problems economic and legislative issues. The cash management is usually

vetëkontrolli janë faktorët më të rëndësishëm për suksesin e kompanive, sipas menaxherëve të sektorit të telekomunikacionit që iu përgjigjën kësaj ankete. Ky grup konsideron, kryesisht, vetë-përbushjen, kënaqësinë nga puna dhe lidhjet me njerzit një motivim për fillimin e sipërmarrjes.

Sektori i telekomunikacionit i rendit çështjet ekonomike dhe legjislative si faktorët kryesorë të jashtëm influencues për problemet operative të korporatave. Vështirësitë për thithjen/impementimin e teknologjisë së re/inovacionit dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme janë konsideruar çështjet kryesorë të brendshme e problematike nga kompanitë e këtij grupi. Në përgjithësi, për sektorin e telekomunikacionit, menaxheri i financave është marrësi i vendimve për menaxhimin e parave. Faktori kryesor që ndikon vendimin e tij, për menaxherët e telekomunikacionit kur konsiderojnë një investim të ri, janë në përgjithësi të ardhurat e pritshme nga ky investim. Mundësia për të investuar në një pasuri më inovative ndikon kryesisht vendimim për shitjen e një aktivi ekzistues, sipas të anketuarve të sektorit të telekomunikacionit. Mundësia për ngritjen e kapaciteteve dhe furnizimi me energji elektrike janë komponentët kryesorë të jashtëm që ndikojnë në performancën e biznesit të telekomunikacionit. Këta menaxherë, në përgjithësi, i konsiderojnë kompanitë e tyre plotësisht jashtë rrezikut të falimentimit dhe për arritjen e kësaj është e nevojshme një periudhë kohë më pak se tre vjet.

Menaxherët e ndërtimit, të cilët iu përgjigjën sondazhit tonë, shpenzojnë 20-30 orë në javë për marrjen e vendimeve strategjike të korporatave dhe po ashtu 20-30 orë në javë për punët administrative. Ashtu si menaxhërt e telekomunikacionit, ata shpenzojnë më shumë kohë me familjen dhe për hobit e tyre. Ndërmarrja e rrezikut dhe vetëkontrolli janë faktorët më të rëndësishëm për suksesin e kompanive, sipas këtij grupi. Pavarësia dhe motivimi financiar, sipas menaxherëve të ndërtimit, që iu përgjigjën sondazhit tonë, janë motivimi kryesor për fillimin e një sipërmarrjeje. Ashtu si menaxherët e telekomunikacionit, të anketuarit e sektorit të ndërtimit vlerësojnë si burime kryesorë të jashtëme për problemet e kompanive, çështjet ekonomike dhe legjislative. Menaxhimi i parave

done by the owner of the company, according to the construction managers' responses. When considering a new investment, this group values expected earnings from this investment. While considering the sale of an asset, the most important factor seem to be the current value of this asset, according to the construction respondents of our survey. Construction managers seem to give similar weights to each external infrastructural factor in terms of effect on their everyday business. Like the telecommunication managers, construction respondents consider their company almost fully recovered from distress, and to achieve this level of recovery was needed less than three years.

The managers of the energy sector seem to spend more than 60 hours at work, and most of this time is dedicated to administrative work, based on our survey. Family and friends are generally their priority for the free time. Need for achievement and self-confidence are the key personal characteristics for company success, according to the energy sector managers. This group ranks self-fulfillment and desire for independence as main motivation for startup business. According to energy sector managers, political and economic issues are the main external factors that cause operational problems to companies. Receivables management and delay in fulfilling bank's obligations are the internal factors that cause the biggest company operational problems, according to them. The owner is the decision maker in the energy business generally, according to our survey. Future earnings are valued most when considering a new investment from the energy sector managers. This group prioritizes the opportunity to invest in a more innovative asset, when assessing the possibility for sale of an existing asset. The qualified workforce and transportation system are the main infrastructural issues of the energy sector respondents. As compared with the two previous sectors, according to our survey, the energy sector seems the least recovered from financial distress.

This section analyses the general trends of

zakonisht bëhet nga pronari i firmës, sipas përgjigjeve të këtyre menaxherëve. Kur shqyrtojnë mundësinë për një investim të ri, grupi vlerëson të ardhurat që priten nga ky investim. Për të konsideruar shitjen e një aktivi, faktori më i rëndësishëm duket të jetë vlera aktuale e kësaj pasurie, sipas të anketuarve të këtij sektori në studimin tonë. Menaxherët e sektorit të ndërtimit duket që i japin të njëjtën peshë secilit faktor të jashtëm infrastrukturor, në aspektin e efektit që jep ky mbi biznesin e tyre të përditshëm. Ashtu si menaxherët e telekomunikacionit, të anketuarit e ndërtimit e konsiderojnë kompaninë e tyre plotësisht jashtë rreziku nga falimentimi dhe për të arritur këtë nivel rikuperimi, është e nevojshme një periudhë kohe më pak se tre vjet.

Menaxherët e sektorit të energjisë duket se shpenzojnë më shumë se 60 orë në punë dhe shumica e kësaj kohe i dedikohet punëve administrative, referuar anketës sonë. Familja dhe miqtë janë përgjithësisht prioriteti i tyre për kohën e lirë. Nevoja për arritje dhe vetëbesimi janë karakteristikat kryesore personale për suksesin e kompanisë, sipas menaxherëve të sektorit të energjisë. Ky grup rendit vetë-përm-bushjen dhe dëshirën për pavarësi si motivimin kryesor për fillimin e këtij biznesi. Sipas menaxherëve të këtij sektori, çështjet politike dhe ekonomike janë faktorët kryesorë të jashtëm që shkaktojnë probleme operacionale për firmat. Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe vonesat në përm-bushjen e detyrimeve ndaj bankës janë faktorët e brendshëm që sjellin problemet më të mëdha operative që ndesh firma. Pronari i kompanisë, në përgjithësi, merr vendimet në biznesin e energjisë, sipas studimit tonë. Kur konsiderohet mundësia për një investim të ri vlerësohen më tepër prej menaxherëve të këtij sektori të ardhurat e pritshme nga ky investim. Ky grup i jep prioritet mundësisë për të investuar në një pasuri më inovative, kur vlerëson mundësinë e shitjes së një aktivi ekzistues. Fuqia punëtore e kualifikuar dhe sistemi i transportit janë çështjet kryesore infrastrukturore të të anketuarve në sektorin e energjisë. Duke e krahasuar me dy sektorët e mëparshëm, sektori i energjisë duket që rikuperohet më pak nga problemet financiare.

Ky seksion analizon trendet e përgjithsh-

the responses to our survey from the telecommunication, construction and energy managers. The next section summarizes the concluding remarks of our research.

IV. Conclusions

This research is a first step for the qualitative analysis of the financial distress characteristics of the telecommunication, construction, and energy sector in Albania. In line with Dhamo and Kume (2015), we considered fifteen companies from the three industries in Albania. We used a revised version of the questionnaire suggested by Nikolic et al. (2015).

Energy businesses seem to put lower priority than the two other sectors in strategic decision making of the business. They consider political issues, transportation system, and qualified workforce as sources of companies' operational problems, differently from the other two sectors. Telecommunication sector managers spend less time in administrative works, as compared with others, according to our survey. They also consider the main internal source of companies' operational problems the difficulty in absorption/acquisition of new technology/innovation. Construction managers seem to balance the working time between strategic decision making and administrative work. The sector seems to have balanced priorities in terms of infrastructural issues of the surrounding region, while the decision making of cash management, as in the case of the energy sector, seems to be mainly a duty of the owner of the company.

Our future efforts will focus on testing the robustness of the observations of this research and the preceding work of Dhamo and Kume (2015), by increasing the number of companies in each industry that will be quantitatively and qualitatively assessed. The correlation of different aspects of the financial ratio analysis, from a corporate bankruptcy potential perspective, and survey results, is another objective for future research.

me të përgjigjeve të sondazhit tonë nga menaxherët e sektorit të telekomunikacionit, ndërtimit dhe energjisë. Seksioni tjetër përmbledh vërejtjet përmbyllëse të kërkimit tonë.

IV. Përfundime

Ky studim është një hap i parë për analizën cilësore të karakteristikave të vështirësive financiare për sektorin e telekomunikacionit, ndërtimit dhe energjisë në Shqipëri. Në përputhje me Dhamo dhe Kume (2015), ne shqyrtuam pesëmbëdhjetë kompani nga tre industritë në Shqipëri dhe përdorëm një version të rishikuar të pyetësorit sugjeruar nga Nikolic et al. (2015).

Bizneset e energjisë duket që i japin më pak prioritet vendimmarrjes strategjike të biznesit krahasuar me dy sektorët e tjerë. Duke pasur parasysh çështjet politike, sistemin e transportit dhe fuqinë punëtore të kualifikuar si burime të problemeve operationale të kompanive, ata ndryshojnë nga dy sektorët e tjerë. Sipas studimit tonë, menaxherët e sektorit të telekomunikacionit shpenzojnë më pak kohë në punët administrative, në krahasim me të tjerët.

Gjithashtu, ata konsiderojnë si burimin kryesor të brendshëm të problemeve operative të kompanive vështirësinë për thitjen/implementimin e teknologjisë së re/inovacionin. Na rezultoi se menaxherët e ndërtimit balancojnë kohën e punës ndërmjet marrjes së vendimeve strategjike dhe punëve administrative. Sektori i balancës prioritetet për sa i përket çështjeve infrastrukturore, ndërkohë që vendimmarrja për menaxhimin e parave, si në rastin e sektorit të energjisë, rezultoi të jetë kryesisht një detyrë e pronarit të firmës.

Përpjekjet tona të ardhshme do të fokusohen në testimin e vëzhgimeve të këtij studimi dhe vazhdimin e punës së Dhamo & Kume (2015), duke rritur numrin e kompanive në çdo industri, që do vlerësohet nga pikëpamja sasiore dhe cilësore. Korrelacioni i aspekteve të ndryshme të analizës së raporteve financiare nga një perspektivë e mundshme falimentimi e korporatave si dhe rezultatet e anketës përbëjnë një tjetër objektivi për kërkimet në të ardhmen.

Reference / Bibliografi

- Ahmad, N.H., Seet, P.S. (2009).** Dissecting behaviours associated with business failure: A qualitative study of SME owners in Malaysia and Australia. *Asian Social Science*, 5(9):98.
- Altman, IE. (1968).** Financial ratios, discriminant analysis and the prediction of corporate bankruptcy. //The Journal of Finance, 23(4/Sep.):589-609.
- Altman, IE. (2005).** An emerging market credit scoring system for corporate bonds. *Emerging Markets Review*, 6(4): 311-323.
- Altman, IE., Danovi, A., Falini, A. (2013).** Z-Score models' application to Italian companies subject to extraordinary administration. //Journal of Applied Finance, 23(1):128-137.
- Altman, IE., Haldeman, R., Narayanan, P. (1977).** Zeta Analysis: A new model to identify bankruptcy risk of corporations. //Journal of Banking and Finance, 1(1/Jan.):29-54.
- Altman, IE., Heine, M. (2000).** Predicting financial distress of companies: Revisiting the Z Score and Zeta Models. *Handbook of Research Methods and Applications in Empirical Finance 09/2000*, DOI: 10.4337/9780857936097.00027.
- Altman, IE., Iwanicz-Drozdowska, M., Laitinen, KE., Suvas, A. (2014).** Distressed Company and Bankruptcy Prediction in an International Context: A Review and Empirical Analysis of Altman's Z-Score Model. Working Paper, (August 10, 2014).
- Dhamo, Zh., Kume, V. (2015).** Tendencies and Characteristics of Financial Distress: An Introductory Comparative Study among Three Industries in Albania. //Athens Journal of Business and Economics. ATINER's Conference Paper. Series ECO2015-1694, Forthcoming.
- Gaskill, LuAnn Ricketts., Van Auken, Howard E., Manning, Ronald A. (1993).** A factor analytic study of the perceived causes of small business failure. //Journal of Small Business Management, Oct 1993, 31, 4, ProQuest: 18.
- Heracleous, L., Werres, K. (2015).** On the Road to Disaster: Strategic Misalignments and Corporate Failure. Long Range Planning.
- Laitinen, E.K., Lukason, O., Suvas, A. (2014).** Behaviour of Financial Ratios in Company Failure Process: An International Comparison. //International Journal of Finance and Accounting, 3(2):122-131.
- Longenecker, C.O., Simonetti, J.L. Sharkey, T.W. (1999).** Why organizations fail: the view from the front-line. *Management Decision*, 37(6):503-513.
- Mellahi, K., Wilkinson, A. (2004).** Organizational failure: a critique of recent research and a proposed integrative framework. //International Journal of Management Reviews, 5(1):21-41.
- Nikolic, N., Dhamo, Zh., Schulte, P., Mihajlovic, I., Kume, V. (2015).** An Analysis of Factors Affecting Failure of SMEs. //International May Conference on Strategic Management in Bor, Serbia – IMKSM 2015: 162-180.
- Ropega, J. (2011).** The reasons and symptoms of failure in SME. //International advances in economic research, 17(4): 476-483.
- Zilbershtein, D. (2013).** A Qualitative Multi Case Study to Explore the Root Causes of Small Business Failure. PHD in BA Dissertation at the North Central University, Minnesota, USA, 2012.